

Analiza e nevojave të nxënësve të shkollave të mesme teknike për anglishten për qëllime specifike

MA. Albulena Pllana Breznica

SHMT “Lutfi MUsiqi” Vushtrri

E-mail: albulena.c@hotmail.com

Abstrakt:

Ky punim merret me konceptin e analizuar për nevojat e nxënësve në kontekstin e mësimit/zbatimit të gjuhës angleze për qëllime specifike në shkollat e mesme teknike të Kosovës. Kjo pasohet nga një vështrim i konceptit aktual të analizës së planprogrameve të gjuhës angleze dhe nevojave për përvetësimin e anglishtes për qëllime specifike.

Analiza e nevojave të nxënësve para rrjedhës së gjuhës angleze për qëllime specifike, si dhe gjatë rrjedhës mund të rezultojë në një kurs që do të mirëpritet në mënyrën më të mire, për të përmbushur nevojat e nxënësve dhe në këtë mënyrë për të përparuar ata për situatat reale që mund të hasin pas përfundimit të shkollës së mesme: punësimit ose për vazhdimin e studimeve në vend apo jashtë vendit, duke pasur parasysh zhvillimin marramendës të teknologjisë në këtë kohë të globalizmit.

Fjalët kyçe: *anglisht për qëllime specifike, shkollat e mesme teknike.*

Hyrje

Gjuha angleze në epokën e sotme të qytetërimit modern konsiderohet përveç shkrim-leximit, si një nga nevojat e një njeriu të arsimuar. Megjithatë, në bazë të planprogrameve për gjuhën angleze për shkolla të mesme teknike, nuk i kushtohet vëmendje e mjaftueshme anglishtes për qëllime specifike, ku është veçanërisht e nevojshme për nxënësit që të kenë njohuri themelore për profesionin e zgjedhur dhe ardhmërinë e tyre. Është e rëndësishme të theksohet më tej se në përcaktimin e nivelit të njohurive nuk vini re një nivel i madh i angazhimit, si nga nxënësit dhe nga profesorë të gjuhëve të huaja. Ky problem duhet zgjidhur duke shfrytëzuar materiale dhe tekste bashkëkohore për shpjegimin e anglishtes për qëllime specifike. Pak vëmendje i është dhënë organizimit të mësimit të gjuhës angleze për qëllime specifike në shkolla të mesme teknike (profesionale), formimi i grupeve bazuar në

nivelin e njohurive, përpunimin e strategjive të mësimit të gjuhës angleze për qëllime specifike, përshtatshmëria e teksteve të përzgjedhura, si dhe dëshirat dhe aspiratat e nxënësve në lidhje me këtë çështje. Vizitat nëpër minifabrika të vendit (Pllana-Breznica, 2016, 27).

Analiza e nevojave të nxënësve para rrjedhës së gjuhës angleze për qëllime specifike

Problemi më i madh është mospërputhja e njohurive dhe aftësive që nxënësit posedojnë për nivelin e kursit që dëgjojnë. Analiza e nevojave të nxënësve para rrjedhës së gjuhës angleze për qëllime specifike, si dhe gjatë rrjedhës mund të rezultojë në një kurs që do të mirëpritet në mënyrën më të mirë, për të përmbushur nevojat e nxënësve dhe në këtë mënyrë për të përgatitur ata për situatat reale që mund të hasin pas përfundimit të shkollës dhe punësimit në vend apo jashtë vendit, duke pasur parasysh zhvillimin marramendës të teknologjisë në kë kohë të globalizimit.

Para se të merremi në përcaktimin e nevojave në kontekstin e gjuhës anglezesh për qëllime specifike duhet të jepet një përkufizim më i gjerë i nevojave më të rëndësishme dhe nevojave më themelore, sipas shkallës së kënaqësisë së tyre mbi pjesët individuale dhe kolektive.

Kur vjen puna për nevojat e nxënësve në mësimdhënie të anglishtes për qëllime specifike Hutchinson (Hutchinson, 1987, 53) beson se duhet të merret parasysh nevojat e nxënësve gjatë planifikimit të përmbajtjes së kursit. Robinson (Robinson 1991, 161) dallon dy lloje të nevojave: *subjektive* dhe *objektive*. Nevojat objektive janë, në fakt, të gjitha informatat faktike në lidhje me pjesëmarrësit: *aftësi të shkëlqyera të gjuhës, vështrësitë në lidhje me gjuhën, përdorim të gjuhës në situata të jetës reale*, ndërkohë që nevojat subjektive janë: *besimi, qëndrimet, pritjet dhe nevojat afektive mësimore* të nxënësve në procesin e të nxënësve. Dudley-Evans & M.J. St. Jones (Dudley-Evans & M.J. St. Jones 1998, 65) kanë bërë një ndarje të nevojave: *aktuale (të çastit)* dhe *të shtyra*. Ndarja e tyre është një nevojë e rëndësishme për kurset e gjuhës angleze për qëllime specifike. Kurset të organizohen zakonisht për nxënësit të cilët i njohin situatat e veçanta në të cilat do të ketë nevojë për anglisht për qëllime specifike. Ndonjëherë është shumë e rëndësishme, se, dituria e fituar në kurs të jetë e nevojshme në kursin e gjuhës angleze gjatë përcjelljes së kursit, ose në një periudhë pas përfundimit të kursit. Nevojat aktuale (të çastit) nënkuptojnë nevojat të cilat nxënësit i posedojnë gjatë përcjelljes së kursit, kurse me termin *nevoja të shtyrakonsiderohen* nevojat e nxënësve që do të jenë të rëndësishme më vonë në një periudhë pas përfundimit të kursit.

Megjithatë, shumica e kurseve për anglishte për qëllime specifike gjenden, në vazhdimësi, në mes të këtyre dy pikave. Mirë do të ishte që anglishtja për qëllime specifike të zhvillohet në klasën e njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë, ndërkohë që nevojat reale të studentëve të ardhshëm të ndodhë në vitin e parë e të dytë të studimeve sëbashku me lëndët profesionale, kurse nevojat e studentëve realisht janë në vitet e fundit të studimeve për shfrytëzim të literaturës për punim të diplomës, ose pasi ata të jenë diplomuar edhe për të marrë një punë. Prandaj, Dudley-Evans & M.J. St. Jones, besojnë se kurset në fushën e gjuhës angleze për qëllime specifike duhet të gjejnë vendin e tyre në vitet e fundit të studimeve në vend të parë dhe të dytë. Nëse kjo nuk është e mundur, ata sugjerojnë, nëse kursi të gjuhës angleze për specifike fillon në vitin e parë e të dytë, atëherë të vazhdojë deri në fund të studimeve.

Hutchinson & Waters (Hutchinson & Waters 1987, 53) kanë përcaktuar e gjuhës angleze për qëllime specifike si qasje të planifikuara të kursit i cili fillon me pyetjen: "Përse nxënësve u duhet gjuha angleze?". Megjithatë, kjo pyetje mund të bëhet për cilindo kurs tjetër në gjuhën angleze, si për anglishten e përgjithshme, ashtu edhe për anglishten për qëllime specifike, sepse të gjitha kurset janë të bazuara në llojin e veçantë të nevojës. Kjo ngre pyetjen: "Çfarë është dallimi atëherë?". Autorët e lartcekur besojnë se në teori nuk ka asnjë ndryshim, ndërsa në praktikë ndryshimi është i madh. Gjithashtu këta autorë më tej argumentojnë se çdo kurs i gjuhës angleze duhet të bazohet në një analizë të nevojave të nxënësve. Duke ndjekur këtë parim, procedurat të cilat zhvillohen për anglishten për qëllime specifike mund të kenë një ndikim pozitiv në gjuhën e përgjithshme angleze.

Në bazë të këtyre autorëve dhe nevojave për të zënë hapin në përvetësimin e anglishtes për qëllime specifike, në shkollat e mesme teknike të Kosovës, duhet të bëhet analiza e nevojave të nxënësve për mësimin e gjuhës angleze, e në këtë mënyrë të sigurohet një arsimim/mësim cilësor.

Robinson (Robinson, 1991, 48) thekson rëndësinë e analizës së nevojave për të planifikuar kursin, të shkruarit e teksteve dhe zgjedhja e mënyrës së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ai gjithashtu rekomandon se analiza e nevojave duhet kryer vazhdimisht, për shkak se shumë pjesëmarrës thellohen në kurs, pikëpamjet dhe qasja e tyre mund të ndryshojnë.

Gjatë analizës së nevojave duhet përgjigjur pyetjeve **kush**, **çfarë**, **kur** dhe **ku**: **kush** është në të vërtetë audienca e synuar (të cilët duhet të jenë të trajnuar), detyra dhe përmbajtja (çfarë duhet të ligjërohet) dhe konteksti apo mjedisi për leksione (**ku** dhe **kur** do të realizohet ligjërata). Pyetja në të cilën analiza e nevojave nuk përgjigjet është **sesi**.

Mësimdhënësit e gjuhës angleze, në bazëtë të dhënave e mbledhura përmes analizës së nevojave të nxënësve duhet të përgjigjen në pyetjen *sesi* dhe me sukses të realizojnë kursin.

Koncepti bashkëkohor i analizës së nevojave

T. Dudley-Evans&M.J. St. Johns(Dudley-Evans 1998, 125) janë përpjekur për të dhënë një koncept bashkëkohorë të analizës së nevojave në bazë të të cilit autorët para se të punuar në kohën dhe mënyrën e funksionimit të analizës së nevojave në kontekstin e gjuhës angleze për qëllime specifike.




Fig. 1. Analiza e nevojave

Për të hyrë më thellë në konceptin e analizës së nevojave të nxënësve në kontekstin e gjuhës angleze për qëllime të veçanta, do të japim një paraqitje grafike për analizën e nevojave. Paraqitja grafike na jep mundësinë për të

vëzhguar analizën e nevojave, si pjesë e një procesi më të madh të planifikuar të një kursi të gjuhës angleze për qëllime të veçanta.

Fazat kryesore për gjuhën angleze për qëllime të veçanta janë:

- analiza e nevojave,
- planifikimi i kursit të gjuhës angleze për qëllime të veçanta,
- përzgjedhja e materialeve,
- mësimdhënia dhe mësimnxënia dhe
- evaluimi.

Analiza e nevojave nuk duhet të shikohet si proces i ndarë dhe i pavarur, sepse ajo varet dhe mbështetet në komponentët e tjerë të kursit të gjuhës së huaj (fig. 2.).




Fig. 2. Fazat e mësimdhëniessë anglishte për qëllime të veçanta (sipas Dudley-Evans&M.J. St. Jones, faqe 121).

Mënyra e analizës së nevojave varet nga situata. Variabla tjera, që mund të ndikojnë, paraqiten në fig. 3.




Fig. 3. Variabla të tjera në kursin e gjuhës angleze për qëllime të veçanta (sipas Dudley-Evans&M.J. St. Jones, faqe 126).

Megjithatë, ndonjëherë nuk është e mundur që të merren informacion në lidhje me pjesëmarrësit e kursit deri në momentin e pjesëmarrjes në kurs. Atëherë është e nevojshme për të përshtatur nevojat e nxënësve/vijuesve në një kurs. Nga puna ime modeste, deri më tani me nxënës të shkollës së mesme teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtrri, kam hasur në shumë vështirësi, si: sigurimin e materialit të nevojshëm për anglishten për qëllime të veçanta, shumëzimin e materialeve, një nivel i pabarabartë i njohurive në të gjitha klasat e XI-ta dhe të XII-ta, numri i lartë i nxënësve që shumë pak kanë mësuar anglisht në shkollat e mesme të ulëta.

Në situatën e përshkruar është reaguar në mënyrë që të gjithë nxënësit janë testuar me gojë dhe bazuar në rezultate kam arrit të formoj dy grupe të nxënësish me nivele të ndryshme të diturisë: fillestar apo mesatar për t’i përfshi në mësimnxënie të materialeve të siguruar për anglishte për qëllime të veçanta (sidomos në klasat e XII-ta).

Përfundime

Analiza e nevojave të nxënësve për gjuhën angleze për qëllime specifike sigurisht nuk përfaqësohetsa duhet në shkollat e mesme teknike të Kosovës.

Këtu jam përpjekur për të treguar rëndësinë e madhe të analizës së nevojave para se të fillon një kurs i një gjuhe të huaj. Analiza e nevojave është e domosdoshme që mësimdhënësi të ketë parasysh edhe nivelin e njohurive që posedojnë vijuesit e kursit, si dhe pritjet e tyre. Në bazë të të dhënave, mësimdhënësi mund të planifikojë cilësinë e kursit dhe kështu të arrijë rezultatet e mundshme më të mira.

Duke përdorur të dhënat e mbledhura mund të projektohet plani kornizë i kursit. Vlerësimi gjithashtu paraqet efektivitetin e kursit.

Qëllimi i analizës së nevojave është që të njoftohen pjesëmarrësit e kursit si njerëz, si përdoruesit e gjuhës, si nxënës, se për të mësuar me sukses gjuhën dhe shkathtësitë e të mësuarit të ngrihet në nivelin më të lartë të mundshëm. Në këtë proces, duhet pasur në mendje mjedisin në të cilin do të mësohet, si dhe situatat e synuara në të cilat për të zbatohen njohuritë e arritura.

Në këtë mënyrë janë të kënaqur mësimdhënësit dhe nxënësit, si dhe shkollat teknike (institucionet shkollore) ku zhvillohet kursi.

Bibliografia

Dudley-Evans & M. J. St. Jones: *“Developments in English for Specific Purpose”*. Cambridge: Cambridge University Press, 1998.

Hutchinson, T. W., *“English for Specific Purpose”*. Cambridge: Cambridge University Press, 1987.

Kanina (Bilimani) V.: *“Zhvillime bashkëkohore të ESP”*, disertacion UT FGJH DGJA, Tiranë, 2015.

Pllana-Breznica, A.: *“The Challenges of introducing an ESP course at the Technical High School “Lutfi Musiqi”*

Vushtrri” master thesis, UEJL Tetovë, 2016.

Robinson, P.: *“ESP Today: a Practitioner’s Guide”*. Hemel Hempstead: Prentice Hall International. 1991.